



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 37, datë 09.05.2022

PËR

MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.3, RRUGA "HYSEN KËRTUSHA" PALLATI NR. 32, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë" (Titulli 3, Bashkëpronësia, Neni 199 dhe vijues), të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të proçesit të rindërtimit", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 202, datë 05.03.2020 "Për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e rindërtimit të banesave individuale", Urdhërit nr. 164, datë 01.07.2020 "Për ngritjen e komsionit të posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e proçesit të rindërtimit", i ndryshuar, të raportit të Komisionit të Posaçëm miratuar nga titullari i institucionit me nr.471/23 prot., datë 26.04.2022, si dhe sipas relacionit të hartuar nga ky komision, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Miratimin e listës së përfituesve, që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin nr. 32, Rruga "Hysen Kërtusha" në Njësinë Administrative nr. 3, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 Nëntor 2019, hartuar nga Komisioni i Posaçëm sipas aneksit 1 bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 10.05.2022

ANEKSI 1. SUBJEKTET PËRFITUESE TË PALLATIT NR.32, RRUGA "HYSEN KERTUSHA"

Nr.	PRONARI	GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATES	STRUKTURA E APARTAMENTIT QË DO PËRFITOHET
1	ARBER KALEMI	4	2+1
2	YMER ÇELA	6	3+1
3	ELIDA ÇELA	2	1+1
4	ESAT HOXHA, NAIME HOXHA	7	3+1
5	ÇELO KORRA, LIRI KORRA, RINO KORRA, MELITA KORRA	2	1+1
6	FATMIR MEHMETI, MERIBAN MEHMETI	3	2+1
7	GURI LLARI	1	1+1
8	LUTFI HOXHA, AFERDITA HOXHA	2	1+1
9	LUMTURI BEHLULI	1	1+1
10	ILIR AVDYLI, MIRLINDA AVDYLI	5	3+1
11	ADMIR AVDYLI	4	2+1
12	LIDA TANI	2	1+1
13	KRISTO LEKAJ, DHORA LEKAJ, ARDIAN LEKAJ, POLIKRON LEKAJ, RUDINA LEKAJ	2	1+1
14	IDLIR PUJA	3	2+1
15	AIDA DOMI, ARIAN BAÇI, BIHANE BAÇI, LULZIM BAÇI	3	2+1
16	ROLANDI KALEMI, MARJANA KALEMI	2	1+1
17	KASTRIOT HOXHA, DOBRICA HOXHA	4	2+1
18	LILJANA POPLLO, ENKELEJDA DODAJ	2	1+1
19	STRATULLA QIRICI, JORGO QIRICI, KATINA MATI, ARDIAN QIRICI	5	3+1
20	SHPRESA TYTO	1	1+1
21	EDLIRA GJYZELI, LUIS GJYZELI, LEDIO GJYZELI	3	2+1
22	ERVEHE BUSHI, NEXHIP BUSHI	2	1+1
23	ARTUR MAMUNANAJ + ADELINA MAMUNANAJ + ARDIAN MAMUNANAJ + ARBEN NANAJ(MAMUNANAJ) + BLERINA MAMUNANAJ + ELMIRA MAMUNANAJ +LEFTERI MAMUNANAJ	1	1+1
24	MUHAMET CELPICA, FERIDE CELPICA, BESNIK CELPICA, EDLIRA CELPICA	4	2+1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 427 prot.
5

Durrës, më 16.05.2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
Durrës

BASHKISË Durrës ✓

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.37 datë 09.05.2022 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në Njësinë Administrative Nr.3 Rr.Hysen Kërtusha” Pallati nr 32, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI
EMILJAN JANI

